



07.02.2024

Në mbështetje të nenit 108/A pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr.04/L-042, I ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237. Ligji Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenit 4 të Rregullave për parashtrimin e ankesave të miratuara nga KRPP, sipas Kërkesës për Rishqyrtim nga **OE NPT Infinit shpk** me seli në Prishtinë të datës: 04.02.2024, si palë e interesuar në procedurën e aktivitetit të prokurimit "**Mini tende 1 furnizim me IT sipas marrveshjes me AQP**" me numër Prokurimit **634-24-136-1-2-5**, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit/ZPP pas analizimit, ekzaminimit dhe shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim me datën: 07.02.2024 nxjerr:

VENDIM

I. Pranohet e pjesërisht e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim e **OE Infinit shpk** me seli në Prishtinë të datës: 30.01.2024 për aktivitetin e prokurimit "**Mini tende 1 furnizim me IT sipas marrveshjes me AQP**" me numër Prokurimit **634-24-136-1-2-5** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Komuna Klina.

ARSYETIM

Pretendimi 1 :

Nga dokumentet të cilat kemi pranuar në qasjen në dokumente zyrtare konstatohet se grupi i OE të rekomanduar për kontratë: EGS SH.P.K. & PATTERN SH.P.K. janë të papërgjegjshëm pasi që nuk plotësojnë specifikimet teknike për pozicionin 9. Skaner. Kërkesë në dosjen e tenderit dhe sqarimet shtese të cilat AK ka ngarkuar me 18.01. ka qene që skaneri të jetë touchscreen LED ndërsa modeli i ofertuar nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë Canon DR-C230 nuk ka opsionin touchscreen, poashtu interpolated resolution është kërkuar 1200x1200dpi ndërsa modeli Canon DR- C230 rezolucionin maksimal zhvillon 600x600dpi që nuk plotëson kualitet shumë me të ulët (50%) me të dobët se kërkesa fillestare e AK. Poashtu memory capacity është kërkuar 512mb ndërsa në broshurën e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë kjo specifikë nuk është cekur fare në broshurë, nga kërkimet tona në internet shihet se modeli Canon DR-C230 ka memorie 256mb. Specifike tjeter të cilën nuk plotëson ky model i skanerit është se Interface USB është kërkuar 3.0 super speed ndërsa modeli Canon DR-C230 ka interface USB me shpejtësi me të vogël 2.0. Specifike tjeter të cilën kemi verifikuar se nuk plotëson ky model është se nuk ka wifi funksionon vetëm me cable.

Pergjigjeja:

I pranohet pjesërisht I bazuar pasi O.E EGS SH.P.K. & PATTERN SH.P.K ka ofertuar me modelin Canon

Pretendimi 2 ;

Grupi i OE te rekomanduar per kontrate poashtu rezulton si i papergjegjshem per faktin se sigurimi i tenderit nuk permban emrin e dy anetarve te grupit ofertues por vetem te liderit EGS .

Pergjigjja 2

Në polisen e sigurimit jane jepur detajet tituli I projektit dhe numeri I Prokurimit dhe vlera Prandaj, pretendimi juaj ankimor edhe mbi këtë bazë ligjore është **I PABAZUAR.**

Pertendimi 3

Grupi i OE te rekomanduar per kontrate poashtu jane te papergjegjshem pasiqe nuk plotesojne kriterin/kerkesen si ne FPO lidhur me kerkesat e pershtatshmerise: - Vertetim nga gjykata - me afat jo me i vjeter se 90 dite (kjo do te kërkohet vetem per te propozuarin me shpërblim me kontrat.) Te dy OE kane dorezuar certifikaten e gjykates me date 10.10.2023. perkatesisht 11.10.2023. qe eshte me e vjeter se 3muaj ne kete menyre AK eshte dashur te mos pranoje si valide keto dokumente dhe te eliminohet oferta si e papergjegjshme pasiqe te dy anetaret e grupit kane dorezuar certifikaten e gjykates me te vjeter se 90dite nga publikimi i njoftimit per kontrate/ fteses per oferte.

Pergjigje 3

Vertetimet tatimore jane ne kuader te afatit te kerkuar ndersa vertetimi I gjykates ka validitet 6 muaj Prandaj, pretendimi juaj ankimor edhe mbi këtë bazë ligjore është **I PABAZUAR.**


AK-Komuna Kline ka përgatitur specifikimet teknike ne harmoni me nevojat e veta dhe në përputhje me qëllimin e prokurimit.

Këshille Juridike

Kundër çdo vendimit te marrë nga AK-komuna Kline ne përputhje me rrethanat e nenit 108/A, çdo palë e interesuar mund te parashtroje ankesë pranë OSHP-së ne pajtim me nenin 109 te LPP-së në afat prej 10 ditësh nga data e pranimit te këtij vendimi.

Labinot Morina

ZYRTARI PËRGJEGJËS I PROKURIMIT



Vendimi i dërgohet:

- **OE Infinitt shpk** (përmes E-Prokurimit).
- **Zyrës se Prokurimit.**

Date: 71.02.24